# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5711
E martë, 26 shkurt 2019
çmimi 0.40 €


## Sundimi i ligjit, kriter i vazhdueshëm për liberalizimin e vizave

FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RIZA SMAKA FAQE 4-5

# KORRIGJIMI I KUFIRIT ME MALIN E ZI NUK VARET VETËM NGA PUNA E KOMISIONIT

Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit, Riza Smaka, ka treguar se ky komision është në pritje të vendimit të Qeverisë për ta filluar procesin e korrigjimit të kufirit Kosovë - Mal i Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka shprehur optimizëm se do të mund të korrigjohet kjo marrëveshje, duke shtuar se komisioni ka argumente të mjaftueshme për këtë. Ai ka theksuar se tani çështja është në duart e qeverisë e cila ka marrë përsipër për të formuar ekip të përbashkët punues me palën malazeze për shënjimin e vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi. Smaka ka thënë se tani nuk varet çdo gjë prej punës së komisionit. Sa i përket demarkimit të kufirit me Serbinë, ai ka thënë se komisioni i ka të gjitha dokumentet e nevojshme për ta mbrojtur vijën administrative në mes të dy shteteve

## LËVIZJA VETËVENDOSJE KËRKON ZBATIMIN E PLOTË TË TAKSËS PËR MALLRAT E SERBISË

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sali Zyba, ka mbajtur të hënën konferencë për media, në të cilën ka folur për moszbatimin e plotë të taksës 100 për qind për produktet nga Serbia dhe Bosnja. Ai ka pohuar se ka manovra të shumta me flamujt e vendosur që nuk përkojnë me vendet e origjinës siç e kërkon udhëzimi administrativ. Gjithashtu, deputeti Zyba ka theksuar se nuk ka fushatë për t'i vetëdijesuar

qytetarët për rëndësinë e kujdesit dhe moskonsumimit të këtyre produkteve FAQE 3

**Ndërpriten punimet në projektin e ndërtimit të hidrocentraleve në Pejë** FAQE 9

## AKTUALE

**PSE TË MITURIT IA FUSIN FLAKËN QENDRËS KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN?!** F. 10

KMDLNj

**PLOTËSIMI I LIGJIT PËR TË PAGJETURIT DO TË PROCEDOHET NË QEVERI NË MUAJIN MARS** F. 7

**FORMOHET KOMITETI PËR GRIPIN SEZONAL** F. 7

## EKONOMI

**MINISTRI LEKAJ PREZANTON PROJEKTET INFRASTRUKTURORE TË PLANIFIKUARA PËR SKENDERAJN** F. 8

**DIJANA ZIVIQ EMËROHET MINISTRE E RE E BUJQËSISË** F. 8

## SPORT

**HAJRIZI: ASGJË NUK ËSHTË E PAARRITSHME** F. 21

**GASHI: PALESTRA QË ZGJATI 13 VJET PËR T'U NDËRTUAR, PËRFUNDON NË QERSHOR** F. 21


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Vuçiqi planifikon ta fillojë debatin e brendshëm për Kosovën

**BEOGRAD, 25 SHKURT** - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi të hënën se në ditët në vijim do të bisedojë me udhëheqësit e tjerë serbë për politikën e Serbisë karshi Kosovës dhe mesazhet e të gjitha shteteve botërore. "Në ditët e ardhshme do të bisedoj me udhëheqjen e Qeverisë për porositë e të gjitha vendeve të botës si dhe do të flasim për platformën e Serbisë për të ardhmen. Nëse ne e plotësojmë 100 për qind pjesën e marrëveshjes së Brukselit, ndërsa shqiptarët asnjë obligim dhe vendosin taksa 100 për qind si dhe zgjedhin persona privatë në qeveri, atëherë shtrohet pyetja nëse politika jonë e përgjegjshme dhe serioze është përgjigjja e vetme e mundshme", tha presidenti Vuçiq në një konferencë për media pas takimit me ministrin e Jashtëm të Francës, Natali Loazo.

Reagimi i presidentit Vuçiq për emërimet në Qeverinë e Kosovës bëhet disa orë pasi kryeministri Ramush Haradinaj emëroi ministre të Bujqësisë, Dijana Zhiviq. Emërimi i saj pasoi pas shkarkimit të Nenad Rikallos nga Lista Serbe, parti kjo që ka mbështetjen e presidentit Vuçiq.

# Maqedonia e Veriut në kërkim të presidentit konsensual

Kryeministri Zoran Zaev paralajmëroi që deri në fund të javës do të dihet emri i kandidatit konsensual. Në takimet e deritanishme nuk është folur për emra konkretë, edhe pse, jozyrtarisht, në bisedime është favorizuar emri i Stevo Pendarovskit

**SHKUP, 25 SHKURT** - Zhvillimet në Kuvendin e Maqedonisë Veriore nuk kanë reflektuar në negociatat për gjetjen e kandidatit të përbashkët për president. Sipas kryeministrit Zoran Zaev, gabimet e përditshme nuk guxojnë t'i cenojnë interesat globale të Maqedonisë së Veriut. "Këto lëshime që po ndodhin janë përditshmëri dhe sigurisht se duhet t'i zgjidhim. Nuk guxojnë në asnjë mënyrë t'i cenojnë interesat globale aq të rëndësishme për qytetarët, shtetin dhe subjektet politike. Pres që procesi të vazhdojë me qëllim që të rreshtohemi pas një kandidati të përbashkët për president", tha kryeministri maqedonas Zoran Zaev.

Deputeti i BDI-së, Artan Grubi, thotë se marrëdhëniet BDI-LSDM janë në nivelin e duhur. "Nuk ka asnjë përçarje në koalicionin qeverisës. Sot jam takuar me përfaqësues të LSDM-së dhe do të takohem edhe gjatë ditës. Vlerësoj se punët vijojnë në mënyrë të duhur dhe nuk duhet pasur asnjë ndikim në marrëdhëniet midis LSDM-së dhe BDI-së", theksoi Artan Grubi, deputet i BDI-së.

Bazuar në zhvillimet brenda koalicionit parlamentar, kreu i ASh-së, Ziadin Sela, ka ndarë mendjen që të mos takohet me kryeministrin Zaev për kandidatin presidencial. "Një gjë të jeni të sigurt, të përbashkët Ziadin Sela dhe ASh, sidomos pas ndodhive të mbrëmshme me Ali Ahmetin dhe BDI-së nuk mund të ketë dhe gjithsecili i cili është në lojë me Ali Ahmetin dhe BDI-në", pohoi Ziadin Sela, kryetar i Aleancës për Shqiptarët.

Kryeministri Zaev paralajmëroi që deri në fund të javës do të dihet emri i kandidatit konsensual. Në takimet e deritanishme nuk është folur për emra konkretë edhe pse, jozyrtarisht, në bisedime është favorizuar emri i Stevo Pendarovskit. Zgjedhjet presidenciale do të mbahen më 21 prill.

# Hoxhaj pret në takim ambasadorin jorezident të Arabisë Saudite, paralajmëron vizitë në këtë shtet

**PRISHTINË, 25 SHKURT (ER)** - Zëvendëskryeministri Enver Hoxhaj ka pritur të hënën në takim ambasadorin e ri jorezident të Arabisë Saudite, Abdelmomen Moammed Sharaf, me të cilin ka diskutuar për raportet dypalëshe në mes të Kosovës dhe Arabisë Saudite si dhe për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve. "Bashkëpunime të reja, sidomos në fushën e zhvillimit ekonomik, do të diskutojmë edhe gjatë vizitës sime në Arabinë Saudite të cilën do ta realizoj së shpejti, duke pasuar forumin ekonomik me biznese nga Arabia që është mbajtur vitin e kaluar në Prishtinë", ka thënë Hoxhaj pas takimit.

Edhe zëvendësministrja e Punëve të Jashtme, Rejhan Vuniqi, ka pritur në një takim pune, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme, ambasadorin jorezident të Arabisë Saudite në Republikën e Kosovës, Abdelmomen Mohammed Sharaf, nga i cili ka pranuar edhe kopjen e letrave kredenciale si ambasadori i ri i këtij shteti.

## Pas djegies së mandateve, opozita do ta marrë hapin tjetër ekstrem

**TIRANË, 25 SHKURT** - Pas lënies së mandateve, opozita po sheh mundësinë e tërheqjes së të zgjedhurve lokalë në të gjithë vendin. Qëndrimi i opozitës pritet të radikalizohet pas protestës kombëtare të 16 marsit, konfirmuan aleatët historikë. "Këto do të diskutohen pas datës 16. Të jeni të sigurt që sulmi i opozitës do të jetë 360 gradë. Në të gjitha institucionet, në të gjithë hapësirën shoqërore, politike dhe ndërkombëtare. Këtë do ta përcaktojmë pas datës 16 mars, kur do të jetë dhe protesta e madhe", deklaroi Dashamir Shehi.

Ndërsa Fatmir Mediu theksoi: "Opozita duhet të bëjë çdo gjë që do ta çojë Shqipërinë në binarët kushtetues dhe evropianë". Por, në bllok partnerët evropianë dhe amerikanë kanë kundërshtuar djegien e mandateve të opozitës. "Ne gjykojmë se ndërkombëtarët kanë marrë pozicionin e vet, tradicional, klasik, që këtu para demokracisë vihet stabiliteti. I mirëkuptojmë. Por, gjykojmë se nga pozicioni i sotëm i demokratëve, ndryshe nga ai që ishte para tre muajve, ka një avancim shumë të madh. Kanë filluar ta kuptojnë edhe ata që sa të jetë Rama do të ketë gjithnjë e më pak stabilitet, gjithnjë e më shumë drogë dhe krim të organizuar. Kështu që jemi edhe në rrugën për t'i bindur edhe ndërkombëtarët për këtë punë", tha Shehi.

Tirana pritet ta ketë peshën kryesore për protestën e ditës së enjte para Parlamentit. Për këtë arsye, Basha krahas aleatëve mblodhi edhe krerët lokalë të kryeqytetit.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Lëvizja Vetëvendosje kërkon zbatimin e plotë të taksës për mallrat e Serbisë

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sali Zyba, ka mbajtur të hënën konferencë për media, në të cilën ka folur për moszbatimin e plotë të taksës 100 për qind për produktet nga Serbia dhe Bosnja. Ai ka pohuar se ka manovra të shumta me flamujt e vendosur që nuk përkojnë me vendet e origjinës siç e kërkon udhëzimi administrativ. Gjithashtu, deputeti Zyba ka theksuar se nuk ka fushatë për t'i vetëdijesuar qytetarët për rëndësinë e kujdesit dhe moskonsumimit të këtyre produkteve

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Janë bërë rreth tre muaj prej kur është vendosur taksa 100 për qind për mallrat nga Serbia dhe Bosnja. Pavarësisht prej kësaj gjendjeje, në marketet e vendit nuk ka asnjë mungesë të këtyre mallrave, madje ka edhe shumë dyshime për kontrabandë dhe keqpërdorime. Kështu ka thënë të hënën në një konferencë për media deputeti i LV-së, Salih Zyba. Ai ka folur për lëshimet në zbatimin e këtij vendimi duke bërë që mallrat nga Serbia të jenë shumë të pranishme në treg dhe për të cilën gjë Qeveria nuk ka shpjegim, ndërsa Ministria e Financave nuk është në nivel të përgjegjësisë. "Presidenti Thaçi, nga partia e të cilit vjen ministri i Financave, që do të duhej me mekanizmat e tij institucional të luftojë kontrabandën, në mënyrë cinike na thotë se është rritur kontrabanda në veri. Pra, kemi një deklaratë që është denoncim shtetëror apo pranim i kolapsimit shtetëror. Presidenti i një vendi thotë se kontrabanda me Serbinë është rritur. Kjo i bie që ai pranon se ka pasur gjithmonë kontrabandë dhe kohët e fundit është rritur", ka thënë Zyba.

Ai ka deklaruar se presidentit kontrabanda po i pengon pikërisht në kohën kur ai dhe partia nga ai vjen po kërkojnë pezullimin e taksës 100 për qind ndaj Serbisë. "Sipas linjës së përgjegjësive në këtë mes janë përgjegjës Ministria e Financave dhe institucionet në varësi si Doganat dhe Antikontrabanda. Përgjegjëse, po ashtu, është Ministria e Punëve të Brendshme me Policinë e Kosovës, Departamenti i Krimit Ekonomik dhe Antikontrabanda. Ndërkaq sa i takon tregut të brendshëm në Kosovë, brengosës është edhe mosreagimi i ministrit të Tregtisë. Ka manovra të shumta me flamujt e vendosur që nuk përkojnë me vendet e origjinës siç e kërkon udhëzimi administrativ. Por për këto shkelje ka pak gjoba dhe konfiskime të mallit. Nuk ka fushatë për të vetëdijesuar qytetarët për rëndësinë e kujdesit dhe moskonsumit të këtyre produkteve", ka thënë Zyba.

Ai ka theksuar se nëse çdo ditë bëhet thirrje për heqjen apo pezullimin e taksës prej presidentit te kryetari i Kuvendit e te ekipi negociator atëherë, sipas tij, si mund të presim që zyrtarët që përballen me kontrabandën "me letra" dhe atë totalisht ilegale do t'i qëndrojnë presionit nga grupet financiare e jo rrallëherë dhe kriminale. "Lëvizja Vetëvendosje, megjithëse e cilëson si të pamjaftueshme këtë tarifë, kërkon zbatimin e plotë të këtij vendimi, ndërkaq në lidhje me kontrabandën dhe keqpërdorimet me produktet të cilat kanë taksën prej 100 përqindësh ditëve në vijim do ta dorëzojë kërkesën për interpelancë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka thënë deputeti Zyba.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për taksën doganore 100 për qind ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina është në fuqi që nga 21 nëntori i vitit të kaluar. Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë bërë thirrje Kosovës që ta heqë këtë masë, duke thënë se ajo nuk përkon me interesat amerikane pasi, si e tillë, ka efekt negativ në vazhdimin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Por, Qeveria e Kosovës, të paktën deri më tani, nuk është zmbrapsur nga vendimi për taksën100 për qind i cili vazhdon të mbetet në fuqi.

# Haradinaj: Sot na duhet shembulli i heroit tonë Enver Hadri që të mos na përsëritet historia

**PRISHTINË, 25 SHKURT (ER)** - "Burrat si Enver Hadri e kanë sjellë Kosovën këtu ku është dhe ua kemi për borxh atyre dhe brezave që kurrë më të mos lejojmë tragjedi të tilla, pra të mos lejojmë t'u ndodhë shqiptarëve Toplica e dytë", kështu ka thënë kryeministri Ramush Haradinaj në Akademinë Përkujtimore me rastin e 29-vjetorit të vrasjes së heroit Enver Hadri që është organizuar nën përkujdesjen e kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Para të pranishmëve të shumtë, kryeministri Haradinaj ka thënë se Enver Hadri është mishërim i fatit të shqiptarit përgjatë dy shekujve, duke shtuar se është nder të kujtohet Enver Hadri, intelektuali dhe veprimtari i madh i lëvizjes për liri dhe shtet, ambasadori i parë joformal i Kosovës në zemër të Evropës politike.

Para të pranishmëve të shumtë, për jetën dhe veprën e Enver Hadrit foli Reshat Sahitaj, bashkëpunëtori më i ngushtë i Enverit, ndërsa të pranishmit i përshëndeti Nediha Grapci, motra e Enver Hadrit.

Flet për "Epokën e re", Riza Smaka

# Korrigjimi i kufirit me Malin e Zi nuk

Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit, Riza Smaka, ka treguar se ky komision është në pritje të vendimit të Qeverisë për ta filluar procesin e korrigjimit të kufirit Kosovë - Mal i Zi. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai është shprehur optimist se do të mund të korrigjohet kjo marrëveshje, duke shtuar se komisioni ka argumente të mjaftueshme për këtë. Ai ka theksuar se tani çështja është në duart të qeverisë e cila ka marrë përsipër për të formuar ekip të përbashkët punues me palën malazeze për shënjimin e vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi. Smaka ka thënë se tani nuk varet çdo gjë prej punës së komisionit. Sa i përket demarkimit të kufirit me Serbinë, ai ka thënë se komisioni i ka të gjitha dokumentet e nevojshme për ta mbrojtur vijën administrative në mes të dy shteteve

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 25 SHKURT** - Anëtari i Komisionit Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit, Riza Smaka, ka deklaruar se ky komision është i gatshëm për ta filluar punën për korrigjimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi. Ai ka deklaruar se tani është në dorë të Qeverisë që ta nisë këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Smaka ka deklaruar se nuk ka ndonjë informatë se kur mund të nisë ky proces. "Qeveria ka marrë përsipër për të formuar ekip të përbashkët punues me palën malazeze për shënjimin e vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi. Ndërsa ne nga aspekti profesional dhe teknik jemi të përgatitur çdoherë që ta bëjmë punën tonë. Në këtë drejtim edhe kryesuesi i komisionit, profesor Bulliqi, ka deklaruar se komisioni është i gatshëm, kurse qeveria tani e ka topin në dorë", ka thënë Smaka.

Ai ka shprehur optimizëm se do të mund të korrigjohet kjo marrëveshje, duke shtuar se komisioni ka argumente të mjaftueshme për këtë. Megjithatë, Smaka ka treguar se tani nuk varet çdo gjë prej punës së komisionit. "Po të ishte kjo çështje nën autorizimin tonë si komision, ne jemi aq të fuqishëm me argumente sa do të kishim shumë lehtë ta rirregullonim këtë çështje. Tani e kemi hendikepin që Kuvendi e ka ratifikuar këtë marrëveshje dhe tani varet shumë prej pikëpamjeve politike të të dyja qeverive. Po e përsëris edhe një herë, se këto janë qëndrime të mia personale, sepse në emër të komisionit flet kryesues,i profesor Bulliqi", ka thënë Smaka.

Në këtë intervistë, Smaka ka folur edhe për demarkimin e kufirit të Kosovës me Serbinë. Sipas tij, komisioni i ka të gjitha dokumentet e nevojshme për ta mbrojtur vijën administrative në mes të dy vendeve si kufi shtetëror. Ai ka deklaruar se nuk ka asgjë kontestuese në këtë vijë kufitare. "E jona është që ta përfillim linjën administrative. Kurse çka vendosin politika e institucionet si Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi, ato janë çështje politike. Por, sa i përket anës profesionale dhe teknike, ne jemi optimistë se çështja do të përfundonte në rregull dhe reciprokisht e pranueshme", është shprehur Smaka.

**"Epoka e re":** *Z. Smaka, muajin tjetër bëhet një vit që kur Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar marrëveshjen për demarkacion me Malin e Zi. A ka ndërmarrë diçka komisioni për korrigjimin e kësaj marrëveshjes?*

**Smaka:** Komisioni Shtetëror për Shënimin dhe Mirëmbajtjen e Kufirit prej momenti të thellimit e ka përcaktuar planin e punës

# varet vetëm nga puna e komisionit

dhe punon rregullisht me dokumente, shkresa dhe akte që i referohen kufirit të Kosovës në përgjithësi. Komisioni është i përgatitur edhe për demarkimin e kufirit me Serbinë, ndërsa sa i përket marrëveshjes me Malin e Zi, tani çështja është në duar të qeverisë, e cila ka marrë përsipër për të formuar ekip të përbashkët punues me palën malazeze për shënjimin e vijës kufitare Kosovë - Mal i Zi. Ndërsa ne nga aspekti profesional dhe teknik jemi të përgatitur çdoherë që ta bëjmë punën tonë. Në këtë drejtim edhe kryesuesi i komisionit, profesor Bulliqi, ka deklaruar se komisioni është i gatshëm, kurse Qeveria tani e ka topin në dorë.

**"Epoka e re":** *Pra, fillimi i punës së komisionit për korrigjimin e kufirit me Malin e Zi varet nga vendimet politike të Qeverisë?*
**Smaka:** Natyrisht. Ne punën tonë me kompetencë do ta kryejmë ashtu siç kemi vepruar deri më tani, ku e kemi hartuar raportin prej 700 faqesh me argumente të fuqishme, në të cilin tregohet se ish-komisioni ka gabuar rëndë. Këtë raport, siç e dini, e kemi dorëzuar në qeveri, pastaj qeveria ia ka dorëzuar Kuvendit. Mirëpo, fatkeqësisht, 80 deputetë të Kuvendit nuk e patën lexuar fare këtë raport, por e patën injoruar dhe patën votuar pro marrëveshjes. Gjendja tani është kjo. Qeverisë i mbetet ana politike që të bashkëpunojë me Qeverinë e Malit të Zi për të filluar ky proces.

**"Epoka e re":** *Si komision, a keni ndonjë informatë se kur pritet të formohet ky grup i përbashkët punues për shënjimin e kufirit?*
**Smaka:** Nuk kam ndonjë informatë se kur do të fillojë ky proces.

**"Epoka e re":** *Sa optimist jeni se do të mund të ndodhë korrigjimi i kësaj marrëveshje në mënyrë që kufiri mes dy shteteve të jetë në Çakorr dhe Kullë?*
**Smaka:** Po të ishte kjo çështje nën autorizimin tonë si komision, ne jemi aq të fuqishëm me argumente sa do të kishim shumë lehtë ta rirregullonim këtë çështje. Tani e kemi hendikepin që Kuvendi e ka ratifikuar këtë marrëveshje dhe kjo varet shumë prej pikëpamjeve politike të të dyja qeverive. Po e përsëris edhe një herë, se këto janë qëndrime të mia personale, kurse në emër të komisionit flet kryesuesi, profesor Bulliqi.

**"Epoka e re":** *Në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi pritet që të ndodhë edhe demarkacioni i kufirit në mes të këtyre dy shteteve. Sa është i gatshëm ky komision të përballet me këtë proces?*
**Smaka:** Mes Kosovës dhe Serbisë ekziston kufiri administrativ sikurse ka ekzistuar edhe me Malin e Zi. Nuk është e kontestueshme asgjë. Duhet ta dinë të gjithë se funksioni themelor i komisionit tonë është demarkimi i kufirit, domethënë shënjimi i kufirit sipas linjës administrative në mes të dy vendeve. Ky shënim nënkupton njëfarë korrigjimi reciprok. Ta zëmë, nëse do t'i merrnin pesë hektarë nga ajo anë, ne do të duhej t'i jepnim pesë hektarë nga kjo ana tjetër. E jona është që ta përfillim linjën administrative. Kurse çka vendosin politika dhe institucionet si Presidenca, Qeveria e Kuvendi, ato janë çështje politike. Por, sa i përket anës profesionale dhe teknike, ne jemi optimistë se çështja do të përfundonte në rregull dhe reciprokisht e pranueshme.

**"Epoka e re":** *Pra, besoni se komisioni ka argumente të mjaftueshme për ta mbrojtur kufirin aktual administrativ në mes të Kosovës dhe Serbisë?*
**Smaka:** Natyrisht se po. Ne i kemi marrë të gjitha dokumentet e mundshme që i referohen kufirit prej vitit 1945 deri në ditët e sotme.

**"Epoka e re":** *Sa sfiduese do të jetë kjo punë për komisionin meqenëse tani kemi të bëjmë me një shtet që nuk e njeh Republikën e Kosovës?*
**Smaka:** Ato janë çështje politike. Dihet që politikat shtetërore serbe janë hegjemoniste. Parakusht për demarkacionin në mes të dyja vendeve është pranimi reciprok i dy shteteve, sepse pa ndodhur kjo nuk mund të vijë as shënjimi i kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Tani për tani Serbia nuk e pranon Kosovën dhe pa u zgjidhur kjo çështje unë nuk shoh mundësi për ta filluar punën tonë si komision.

# Në mungesë të kuorumit, platforma për dialogun s'kalon në Komisionin për Punë të Jashtme

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, kryesuar nga Vjosa Osmani, kryetare e Komisionit, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën është shqyrtuar Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë si dhe platforma për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.
Në fillim të mbledhjes, deputetja Doruntinë Maloku ka kërkuar që platforma për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, të hiqet nga rendi i ditës ngaqë, sipas saj, ajo duhet shqyrtuar, pasi të miratohet Projektligji për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.
Propozimi i deputetes Maloku u hodh në votim dhe komisioni me shumicë votash vendosi që mbledhja të vijojë me pikat e parapara për këtë takim. Pas kësaj, komisioni shqyrtoi Projektligjin dhe amendamentet e tij, për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.
Pas shqyrtimit të amendamenteve (2 sosh), komisioni vendosi që me pesë vota për dhe katër kundër, këtë projektligj ta procedojë tutje sipas Rregullores së Kuvendit.
Në mungesë kuorumi për votim nuk ka kaluar platforma për dialogun mbi marrëveshjen përfundimtare, gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

## Drejtori i ATK-së kërkon ndihmën e ministrit Tahiri për luftimin e ekonomisë joformale

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka pritur të hënën në takim drejtorin e përgjithshëm të ATK-së, Ilir Murtezaj, me të cilin ka biseduar rreth bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në fushën e drejtësisë. Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, gjatë këtij takimi ka pohuar se ndër prioritetet e institucionit që drejton do të jetë parandalimi dhe luftimi i ekonomisë joformale mirëpo, sipas tij, luftimi i kësaj dukurie është i pamundur të bëhet vetëm nga pjesa e përgjegjësisë së ATK-së, për këtë qëllim ai ka kërkuar përkrahje nga dikasteri i drejtësisë. Ndërkaq ministri Tahiri ka shprehur gatishmërinë për përkrahje të plotë për të gjitha proceset e punës që ndërlidhën me sistemin e drejtësisë.

# Sundimi i ligjit, kriter i vazhdueshëm për liberalizimin e vizave

Njohësit e integrimeve evropiane kanë thënë se institucionet e Kosovës duhet t'u japin dëshmi vendeve të Bashkimit Evropian se është shënuar përparim në fuqizimin e sundimit të rendit dhe ligjit në mënyrë që Kosova ta marrë liberalizimin e vizave

**Prishtinë, 25 shkurt** - Vendet si Gjermania, Franca, Holanda dhe disa shtete të tjera të Bashkimit Evropian, sipas analistëve, po hezitojnë t'i hapin dyert e tyre për shtetasit e Kosovës, përmes liberalizimit të vizave, për faktin se në Kosovë nuk është shënuar progres i duhur në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Taulant Kryeziu nga Instituti i Kosovës për Politika Evropiane (EPIK), duke folur për "Radion Evropa e Lirë", thotë se institucionet e vendit duhet të punojnë për fuqizimin e rendit dhe ligjit nëse dëshirojnë që Kosova ta ketë liberalizimin e vizave. "Çka duhet të bëjnë institucionet e Kosovës? Institucionet duhet të kuptojnë se sundimi i ligjit është kryefjala. Këtë e kanë thënë të gjithë përfaqësuesit e vendeve të BE-së. Vendimmarrja për liberalizim të vizave për Kosovën nga vendet e BE-së lidhet me luftën kundër krimit dhe korrupsionit të profileve të larta. Institucionet tona duhet të tregojnë se sistemi i drejtësisë ka kredibilitet dhe integritet t'i gjykojë rastet e korrupsionit të personave që janë pjesë e profilit të lartë politik", ka thënë Kryeziu.

Procesi i liberalizimit të vizave ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka filluar në vitin 2012. Bashkimi Evropian i kishte vënë Kosovës si detyrë të plotësojë 95 kritere për ta marrë rekomandimin pozitiv për liberalizim të vizave nga Komisioni Evropian.

Një rekomandim të tillë Komisioni Evropian e ka bërë në korrik të vitit 2018, ndërkaq në shtator të po atij viti Parlamenti Evropian kishte votuar në favor të liberalizimit të vizave për Kosovën.

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar Këshilli i Ministrave nuk e vendosi fare në agjendën e takimit të tyre çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën.

Ministrja e Integrimit Evropian në Qeverinë e Kosovës, Dhurata Hoxha, në vazhdimësi ka theksuar se Kosova ka përmbushur të gjitha kriteret nga udhërrëfyesi për liberalizim e vizave. Ditë më parë ajo ka theksuar se çështja e liberalizimit të vizave mbetet në Këshillin e Ministrave, ku ministrat e brendshëm të vendeve anëtare të BE-së i japin vlerësimet e tyre. "Kemi kërkesa të vazhdueshme që sa më shpejt vendimi për liberalizim të vizave për Kosovën të futet në Këshillin e Ministrave. Ne jemi te hapi i fundit, votimi në Këshillin e Ministrave dhe, porsa të përfundojë ky votim, atëherë çështjet e tjera janë procedurale dhe mbetet vetëm hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave", ka thënë Hoxha.

Edhe analisti i integrimeve evropiane, Taulant Kryeziu, ka theksuar se sa i përket anës teknike të vlerësimit, Komisioni Evropian ka përfunduar punën në korrik kur i ka rekomanduar të dy trupave legjislativë - Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Sipas tij, Komisioni Evropian ka ardhur në përfundim që janë përmbushur kriteret por, siç thekson Kryeziu, këtë mendim të njëjtë nuk e ndajnë disa prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian si Franca, Gjermania, Holanda. "Të gjitha institucionet e Kosovës duhet të kuptojnë një gjë, se vendimmarrja për këtë proces iu takon vendeve anëtare të BE-së. Nuk e ka në dorë as Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, e as komisionari për Zgjerim, Johanes Hahn dhe asnjë përfaqësues i Komisionit Evropian, pasi që e kanë përfunduar e kanë dhënë rekomandimin dhe tani vendimmarrja është te vendet e BE-së. Atë vendimmarrje ato e shprehin përmes vullnetit politik që e kanë në kuadër të Këshillit të BE-së i cili vendos për këtë proces", është shprehur Kryeziu.

Komisionari për Zgjerim i Bashkimit Evropian, Johannes Hahn, pati përmendur vitin 2020 si kohën më optimale kur Kosova do të mund sërish të presë një vendim eventual pozitiv për liberalizimin e vizave. Kosova është vendi i vetëm në rajon, qytetarët e së cilës i nënshtrohet regjimit të vizave në Zonën Shengen.

## Pjesa e parë e Maturës Shtetërore mbahet nga data 5 deri më 8 qershor

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim për caktimin e datave të mbajtjes së provimit të Maturës Shtetërore për afatin e qershorit. Sipas këtij vendimi, pjesa e parë e Maturës Shtetërore do të mbahet nga data 5 deri më 8 qershor, ndërsa pjesa e dytë nga data 19 deri më 22 qershor.

Provimi do të mbahet në katër lëndë, tri nga të cilat obligative dhe një me zgjedhje nga vetë nxënësit. Vendimit i është bashkëngjitur edhe lista e lëndëve me zgjedhje për të gjitha gjimnazet dhe shkollat e arsimit profesional e që janë lëndët: Fizikë, Kimi, Biologji, Informatikë, Gjeografi, Histori, Sociologji, Psikologji, Ekonomi me ndërmarrësi, Edukatë qytetare, Histori e artit, Teori e muzikës dhe harmoni. Në vendimin e ministrit Bytyqi bëhet me dije se tërheqja publike e shortit për renditjen e mbajtjes së provimit të Maturës Shtetërore nëpër regjione bëhet më 3 qershor.

# Formohet Komiteti për Gripin Sezonal

**Në mbledhjen e parë të Komitetit për Gripin Sezonal u konstatua se nga 1 tetori i vitit të kaluar deri më sot, në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, janë raportuar gjithsej 29 938 raste të dyshimta me grip (ILI), 4 719 raste me ARI (infeksion respiratori akut) dhe 43 raste me SARI (infeksion i rëndë respirator akut)**

EPOKA E RE — Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 SHKURT - Është formuar Komiteti në nivel të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës i cili do ta përcjellë gjendjen epidemiologjike me gripin sezonal. Komitetin e përbëjnë: Dr. Basri Sejdiu, drejtor i Përgjithshëm i ShSKUK-së, prof. Naser Ramadani, drejtor i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, prof. Hamdi Ramadani, drejtor i Klinikës Infektive, dr. Basri Lenjani, drejtor i Klinikës Emergjente, prof. Nehat Baftiu, drejtor i Klinikës së Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv, dr. Drita Telaku - Qosaj, drejtoreshë e Klinikës së Pediatrisë dhe dr. Rukije Mehmeti, drejtoreshë e Klinikës së Pulmologjisë.

Komiteti do ta përcjellë situatën për çdo ditë.

Në mbledhjen e parë të Komitetit u konstatua se nga 1 tetori i vitit të kaluar deri më sot, në kuadër të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, janë raportuar gjithsej 29 938 raste të dyshimta me grip (ILI), 4 719 raste me ARI (infeksion respiratori akut) dhe 43 raste me SARI (infeksion i rëndë respirator akut). Deri tani janë raportuar 3 116 raste me grip sezonal, 285 raste me infeksion akut dhe nëntë raste me infeksion të rëndë respirator akut. U konstatua se ka katër raste të verifikuara të vdekjeve me AHN1 dhe gjashtë raste me influencën e gripi A.

Ndërkaq Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës ka dhënë disa konstatime sa i përket gripit: 1. Kemi të bëjmë me epidemi të gripit sezonal; 2. Rekomandimet e gjertanishme të Institutit Kombëtar dhe Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar mbeten në fuqi dhe vlejnë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke ritheksuar edhe një herë masat e domosdoshme në të gjitha institucionet shëndetësore; 3. Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë i rekomandojmë që të gjitha institucionet parashkollore, fillore dhe të mesme (publike dhe private) ku fëmijët dhe nxënësit kanë shenja dhe simptoma të gripit (temperaturë të lartë, lodhje, rrjedhje të hundëve, dhimbje fyti, kollë, barkqitje dhe vjellje, dhimbje koke, barku dhe muskujsh) t'i shmangen kontaktit me nxënës të shëndoshë dhe të qëndrojnë në shtëpi, duke iu përmbajtur rekomandimeve të mjekut; dhe 4. Instituti Kombëtar dhe ShSKUK përsërisin rekomandimet për qytetarët që të kenë kujdes mos të dalin në ambient të ftohtë, të mos qëndrojnë në lokale të mbyllura me dendësi të madhe të njerëzve dhe të përdorin sa më shumë lëngje të nxehta dhe vitamina.

# Plotësimi i Ligjit për të Pagjeturit do të procedohet në qeveri në muajin mars

EPOKA E RE — Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim përfaqësuesit e familjarëve të të pagjeturve. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se arsyeja e këtij takimi ka të bëjë me faktin se shpresohet se një ditë do të arrihet një marrëveshje me Serbinë, marrëveshje e njohjes reciproke, por edhe një pajtim. "Pa e shtrirë dorën e pajtimit ata të cilët kanë ende familjarë të pagjetur, edhe pajtimi është i vështirë dhe dëshirojmë që në periudhën para këtij dialogu ta trajtojmë me respekt edhe këtë temë", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se kjo është një plagë për të gjithë, pa marrë parasysh përkatësinë etnike.

Duke falënderuar komisionin qeveritar, si dhe shoqatat e familjarëve të të pagjeturve, kryeministri Haradinaj dhe të pranishmit diskutuan për pozicionin ligjor të kategorisë së të pagjeturve, se çfarë ka mbetur pa u trajtuar ende në këtë aspekt. Kryeministri Haradinaj u zotua që për secilën shoqatë që trajton të pagjeturit dhe çështjet e hulumtimit të të zhdukurve që lidhen me luftën, të ndahet një buxhet logjistik për angazhimet të cilat i kanë. Njëkohësisht, u bë me dije se plotësimi i Ligjit për të Pagjeturit do të procedohet për miratim në qeveri në muajin mars të këtij viti.

Kryeministri Haradinaj ka shtuar se janë në përpjekje e sipër për ta definuar dialogun dhe se kjo ende nuk është definuar mirë as nga pala e Kosovës, por as nga pala serbe. Megjithatë, kryeministri ka pohuar se delegacioni i Kosovës që shkon në bisedime me Serbinë duhet të konsultohet me familjarët e të pagjeturve. "Do t'i propozoj delegacionit shtetëror për bisedime që të bashkëpunojë me ju, si me komisionin, ashtu edhe me përfaqësuesit e shoqatave, në mënyrë që edhe tema e të pagjeturve në bisedimet Kosovë - Serbi ta ketë pozicionin e vet të merituar", është shprehur Haradinaj, duke theksuar se, nëse duan paqe, vërtet nuk mjafton veç të pajtohen politikanët, por mirë do të ishte të pajtohen edhe popujt.

Haradinaj para këtij takimi priti në zyrën e vet disa nga familjarët e të pagjeturve të cilët e falënderuan kryeministrin për mbështetjen që qeveria e ka dhënë dhe po e jep në vazhdimësi për familjarët dhe për zbardhjen e fatit të të pagjeturve, ndërkaq familjarët kërkuan që t'i bëhet trysni politike Serbisë për zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

## Dijana Ziviq emërohet ministre e re e Bujqësisë

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Pas shkarkimit të ish-ministrit të Bujqësisë, Nenad Rikallo, kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar Dijana Ziviq, ministre të re të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. "Kam emëruar sot ministre të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq. Ministres së re i dëshirova suksese në detyrën e saj dhe e sigurova për mbështetjen time të plotë në shërbim të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për përmbushjen e objektivave të këtij dikasteri qeverisës", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Ish-ministri Nenand Rikallo u shkarkua para pak ditësh pasi Partia Socialdemokrate e Kosovës e kushtëzoi votimin e buxhetit të vitit 2019 me shkarkimin e tij.

# KOMITETI I PPP-së FUNKSIONALIZON NJËSINË PËR MONITORIMIN E PROJEKTIT TË AEROPORTIT 'ADEM JASHARI'

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Nën udhëheqjen e ministrit të Financave, Bedri Hamza, të hënën është mbajtur takimi i Komitetit të Partneritetit Publiko-Privat (PPP), i cili, ndër të tjera, ka shqyrtuar propozimin për funksionalizimin e njësisë për monitorimin e projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", si dhe shqyrtimin e planit për zhvillimin e programit kombëtar për Partneritet Publiko Privat. Me këtë rast, anëtarët e komitetit aprovuan vendimin që ekipi për menaxhimin e Projektit të ANP-së "Adem Jashari" të jetë Divizioni për Monitorimin e projekteve për PPP-në brenda Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat si dhe Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat ta hartojë Programin Zhvillimor për PPP-në në bashkëpunim me të gjitha Autoritetet Kontraktuese në Kosovë dhe të formohet lista e projekteve të mundshme dhe të adresohen me modelin PPP.

Gjithashtu, anëtarët e Komitetit vendosën që Departamenti Qendror për Partneritet Publiko-Privat ta hartojë programin zhvillimor për PPP-në në bashkëpunim me të gjitha autoritetet kontraktuese në Kosovë si dhe të formohet lista e projekteve të mundshme dhe të adresohen me modelin PPP.

## Ministri Lekaj prezanton projektet infrastrukturore të planifikuara për Skenderajn

**Prishtinë, 25 shkurt (ER)** - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, ka prezantuar të hënën projektet infrastrukturore të planifikuara për Komunën e Skenderajt. Ai ka bërë me dije se buxheti prej 1 milion e 660 mijë eurosh në vitin 2019 do të shpenzohet në këto projekte në Skenderaj: Ndërtimi i rrugës Açarevë-Siqievë dhe Açarevë-Plluzhinë, ndërtimi i rrugës Kotorr-Qubrel, ndërtimi i rrugës Syreigan-Pemishtë, ndërtimi i rrugës në Polac, ndërtimi i rrugës Kuqicë-Tërnavc, ndërtimi i rrugës Skenderaj-Vushtrri (fshati Krasmirovc), vazhdimi i rrugës 17 shkurti dhe rregullimi i rrugës Rezallë e Re-Rrezallë e Vjetër. "Vazhdojmë punën në secilën komunë, që t'u ofrojmë qytetarëve rrugë cilësore", ka thënë ministri Lekaj.

# NDËRPRITEN PUNIMET NË PROJEKTIN E NDËRTIMIT TË HIDROCENTRALEVE NË PEJË

**Qeveria e Kosovës ka ndërprerë të gjitha procedurat sa i takon ndërtimit të hidrocentralit në rrjedhën e Lumëbardhit në grykën e Rugovës në Pejë. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se ka kërkuar ndërprerjen procedurave deri në krijimin pasqyrës së qartë se cili mund të jetë ndikimi në mjedis i ndërtimit të këtij hidrocentrali**

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 25 SHKURT - Pas protestës së qytetarëve në Pejë dhe shqetësimeve legjitime të ngritura në takim nga përfaqësuesit e komunitetit rugovas rreth projektit të ndërtimit të hidrocentraleve në Lumbardhë, kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar ndërprerjen e menjëhershme të procedurave të mëtejme deri në krijimin e një pasqyre të qartë dhe të gjithanshme për shkallën e impaktit të këtij projekti në mjedis. Kryeministri Haradinaj ka thënë se projektet të cilat bien ndesh me interesat e banorëve të zonës së Rugovës asnjëherë nuk do të kalojnë.

Para se ta urdhëronte ndërprerjen e punimeve në projektin e ndërtimit të hidrocentraleve në Lumbardhë, ka pritur të hënën në takim një delegacion të përfaqësuesve të komunitetit rugovas, me të cilët ka biseduar rreth shqetësimeve të tyre lidhur me këtë projekt. Kryeministri Haradinaj, pasi është njoftuar nga banorët e kësaj ane për shqetësimet e tyre, u ka premtuar se do t'i trajtojë me kujdes në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e pranueshme dhe e favorshme për banorët dhe investitorët potencialë.

Avokati i Popullit, Hilmi Jashari, ka bërë me dije se është duke i monitoruar nga afër reagimet dhe pakënaqësitë e qytetarëve lidhur me ndërtimin e hidrocentralit në lumin Lumbardhë. Edhe pse zhvillimi i formave të ndryshme të sigurimit të energjisë së qëndrueshme është procesi pashmangshëm dhe kërkesë e kohës, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pacenueshme dhe bazë e rendit juridik në Republikën e Kosovës dhe kërkon që shteti ta vlerësojë me kujdes interesin në mes të rëndësisë së prodhimit të energjisë përmes hidrocentraleve në raport me ndikimin në mjedis që mund të jetë i rëndë.

Avokati i Popullit konsideron se është më se e nevojshme që institucionet ta shqyrtojnë seriozisht kërkesën e qytetarëve për mbrojtjen e lumit dhe mjedisit si një e vetme dhe e patjetërsueshëm në mënyrë që të bëhet balancim i drejtë në mes të interesave të qytetarëve për mbrojtje të mjedisit, të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të zhvillimit të hidroenergjisë.

Avokati i Popullit rikujton të gjithë se e drejta e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje është e drejtë e garantuar me Kushtetutën e vendit dhe me standardet ndërkombëtare, proces i cili i jep mundësi secilit që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo ose ai jeton. "Institucionet, në veçanti, duhet ta respektojnë të drejtën e qytetarëve për informim për çështjet mjedisore, si proces i pashmangshëm, i cili duhet t'i paraprijë çdo projekti me ndikim në mjedis.

E drejta për informata mjedisore, e drejta e publikut në vendimmarrje mjedisore dhe qasja në drejtësi janë të drejta të njeriut dhe parime mbi të cilat bazohet i tërë legjislacioni që rregullon fushën e mjedisit në vend", është thënë në deklaratën e Avokatit të Popullit.

Edhe Partia Socialdemokrate (PSD) është solidarizuar me qytetarët e Pejës në kundërshtimin e ndërtimit të hidrocentraleve në lumin Lumbardhë. "Të konsideruara si projekte strategjike të investimeve nga Komiteti Ndërministror për Investime Strategjike, propozimet e paraqitura nga 'Kelkos Energy' për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Lumbardhë janë një dëm i madh ndaj mjedisit dhe do të sjellin pasoja të mëdha për qytetarët e Pejës. Dëshmia më e mirë është në fqinjësi, në Deçan, ku e njëjta kompani ka ndërtuar tre hidrocentrale dhe sot fshatra të shumtë përballen me reduktime të ujit", është thënë në reagimin e PSD-së.

Sipas kësaj partie, nuk mund të quhet investim strategjik asnjë projekt që e shkatërron natyrën dhe potencialin turistik. "Një investim i tillë është, po ashtu, në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal, të miratuar nga Kuvendi Komunal i Pejës, që ndalon investimet në hidrocentrale. Si zakonisht, historia duket se përsëritet: procedura ligjore të parespektuara, degradim i mjedisit lokal dhe vendimmarrës të papërgjegjshëm", është theksuar në reagim.

Partia Socialdemokrate konsideron se rezistenca ndaj ndërtimit të hidrocentraleve në Lumbardhë nuk është vetëm çështje e qytetarëve të Pejës, por e gjithë shoqërisë në Republikën e Kosovës.

# PSD-ja shtrihet edhe në Istog

**Istog, 25 shkurt (ER)** - Partia Socialdemokrate (PSD) ka hapur degën edhe në Komunën e Istogut. Duke e vlerësuar të rëndësishme shtrirjen organizative në Istog, nënkryetari i PSD-së, Visar Ymeri, sekretarja e përgjithshme Aida Dërguti dhe koordinatori i degës, Burim Fejza, kanë prezantuar platformën socialdemokrate para mbështetësve dhe simpatizuesve.
Në njoftimin e PSD-së është thënë se programi social e zhvillimor i PSD-së është përgjigjja e duhur dhe konkrete për shërbime cilësore publike, transparencë radikale të shpenzimeve të parasë publike, investime nëpër të gjitha lagjet e fshatrat dhe për politika publike në mbështetje të më të varfërve.
"Potenciali natyror i Istogut është mundësi për zhvillimin e turizmit dhe bujqësisë, me mbrojtje të mjedisit dhe me model alternativ për bujqit. Qeverisjet e vlerësuara ndërkombëtarisht në Prishtinë dhe në Kamenicë janë referencat më të besueshme për politikat e kapacitetet e PSD-së për ta modernizuar dhe transformuar pozitivisht qeverisjen lokale në shërbim të të gjithë qytetarëve. Kjo do të dëshmohet së shpejti edhe në Istog dhe në secilën komunë të Republikës", është thënë në njoftimin e PSD-së e cila drejtohet nga Shpend Ahmeti.

# Mbahet debati për zhvillimin e turizmit në bjeshkën e Moknës

**Pejë, 25 shkurt (ER)** - Komuna e Pejës, në bashkëpunim me Komunën e Tutinit, Agjencinë për Zhvillim Rajonal të Sanxhakut (SEDA), organizatën joqeveritare "Merimangat e Pejës", klubin bjeshkatar "Ahmica" nga Rozhaja dhe Institutin për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER) janë duke e realizuar projektin rajonal "Bjeshka e Moknës - perla e pazbuluar në shtegun Via Dinarica", i cili ka mbledhur përfaqësuesit e komunave, organizatat turistike vendore, klubet sportive dhe bjeshkatare, agjencitë turistike dhe organizatat joqeveritare, të cilat së bashku e ndajnë këtë bjeshkë: komunat Rozhajë, Pejë, Istog, Zubin Potok dhe Tutin.
Këtë muaj nikoqire e forumit të dytë të projektit "Via Dinarica" është Komuna e Pejës. Fjalë rasti në këtë takim ka mbajtur drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Pejës, Xhenet Syka, dhe drejtori i InTER-it, Dragisha Mijaçiq. Me anë të këtij projekti mendohet të vendoset marrëdhënia në mes të zyrtarëve komunalë, afaristëve të turizmit dhe njësive lokale në mënyrë që bashkërisht të punohet për zhvillimin e turizmit dhe promovimit të bjeshkës së Moknës, si një destinacion i veçantë turistik që ofron përmbajtje atraktive për pushim aktiv. Projekti do të zgjatë deri në fillim të muajit qershor, ndërsa financohet nga granti i ndarë i kornizës së projektit për zhvillim dhe promovim të turizmit, të cilin e financon Bashkësia Evropiane, ndërsa zbatohet nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

# Kërkohet repelimi i kafshëve si masë parandaluese kundër etheve hemorragjike

**Malishevë, 25 shkurt (ER)** - Nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e cila është mbajtur të hënën, ka kërkuar nga Ministria e Bujqësisë që ta kryejë repelimin e kafshëve si masë parandaluese ndaj virusit të Etheve Hemorragjike Krime Kongo (EHKK) pasi, sipas tij, vitin e kaluar ka dështuar në kryerjen e këtij obligimi. Po ashtu, nënkryetari Berisha ka kërkuar nga këshilli ndërministror për luftimin dhe parandalimin e EHKK-së, që sa më shpejt të mbajë takim dhe t'i autorizojë organet kompetente për zbatimin e masave parandaluese në raport me ethet hemorragjike pasi, sipas tij, vitin e kaluar ka dështuar repelimi i kafshëve si një prej masave më efektive në parandalimin e këtij virusi. Gjithashtu, Berisha ka kërkuar nga sektori i shëndetësisë që t'i vazhdojë fushatat e vetëdijesimit dhe zhvillimin e procedurave për spërkatjen e zonave endemike si masa parandaluese.
Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve të Komunës së Malishevës është raportuar për disa nga aktivitetet që drejtoritë komunale janë duke i zhvilluar si në fushën e investimeve kapitale, po ashtu edhe në aktivitetet e tjera që lidhen me zbatimin e përgjegjësive dhe detyrave nga ana e drejtorive përkatëse. Në këtë mbledhje është bërë me dije se janë duke u bërë përgatitjet për shënimin e "Epopesë së UÇK-së" si dhe për shënimin e Ditës së Mësuesit, ku janë paraparë të zhvillohen një varg aktivitetesh.

# Bahtiri kërkon që e diela të jetë ditë pushimi për të gjithë

**Mitrovicë, 25 shkurt (ER)** - Drejtuar nga kryetari i komunës, Agim Bahtiri, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale. Në këtë mbledhje, drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka njoftuar ekzekutivin lidhur me Panairin e Punës i cili në Mitrovicë do të mbahet më 12 prill në sallën e sporteve "Minatori", ku tha se panairi do të organizohet në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës dhe Zyrës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) dhe nga ana e komunës do të bëhen të gjitha përgatitjet e nevojshme për një organizim sa më të mirë.
Ndërsa drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka njoftuar bordin se është duke u punuar për respektimin e orarit të punës të subjekteve afariste, ku me këtë rast kanë ndërmarrë aksion për mbylljen e lokaleve të cilat nuk e respektojnë orarin e punës sipas Rregullores Komunale nr. 03/2014 dhe mbylljen e lojërave të fatit të cilat zhvillojnë veprimtaritë e tyre pa licencë.
Nga ky aksion, drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, ka thënë se gjatë fundjavës janë mbyllur gjithsej 20 biznese, tri markete të mëdha, dy barnatore, 15 bastore dhe dy kazino. Ai ka thënë se ky aksion do të vazhdojë edhe në ditët e ardhshme derisa të zbatohet Rregullorja komunale në fuqi.
Në fund kryetari Bahtiri ka lavdëruar punën e drejtorit të Inspeksionit, Hysni Ahmeti, duke ofruar mbështetjen e tij të plotë që Komuna e Mitrovicës të funksionojë me rregulla evropiane, ku dita e diel të jetë ditë pushimi për të gjithë.

Reagim i KMDLNj-së

# PSE TE MITURIT IA FUSIN FLAKËN QENDRËS KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN?!

Sipas informatave të KMDLNj-së, disa të dënuar për vepra penale dhe atyre që iu është shqiptuar masa edukative e që janë të mitur, përsëri i kanë futur flakën njërës prej dhomave ku janë duke qëndruar e që paraprakisht kanë kaluar në një dhomë tjetër.

KMDLNJ ka kontaktuar drejtorin e QKMF në Lipjan nga i cili është informuar se për fat të mirë, përveç dëmeve materiale, nuk ka të lënduar as në mesin e të miturve e as në mesin e stafit korrektues.

Nga përvoja monitoruese e KMDLNj-së del se nuk ka një program të duhur për trajtimin, rehabilitimin dhe risocializimin e personave të mitur të privuar nga liria. Përkundër përpjekjes maksimale të stafit dhe vullnetit që me të miturit të ndërtojnë një raport thuaja familjar, deri më tani kanë dështuar thuaja të gjitha përpjekjet dhe për këtë ndikojnë rrethanat si dhe qasja ndaj të të miturve të privuar nga liria.

Të miturit e privuar nga liria janë komunitet shumë i ndjeshëm dhe shumë i cenueshëm i cili kërkon dhe meriton kujdes dhe trajtim të veçantë në përputhje me moshën, përgatitjen shkollore, gjendjen ekonomike, ambientin social në të cilin janë rritur dhe janë zhvilluar dhe që kanë ndikuar në përfshirjen e tyre në aktivitete të kundërligjshme.

Është fakt i pamohueshëm se stafi aktual korrektues në QKMF në Lipjan, përkundër përpjekjeve dhe vullnetit të treguar si dhe tolerancës që e kanë dëshmuar shumë herë, nuk janë të profilizuar dhe profesionalizuar për të punuar me të mitur, sikur që veprohet në shtetet tjera. Programi për risocializim që zbatohet për të gjithë personat e privuar nga liria nuk mund të zbatohet te komuniteti i të miturve të privuar nga liria prandaj edhe kemi dështime në procesin e risocializimit të tyre, të riintegrimit në shoqëri dhe uljen e shkallës së përsëritjes së veprës - recidivizmit.

Mungesa e psikologëve dhe sidomos pedagogëve apo edukatorëve ka ndikuar shumë në dështimin e programit të risocializimit ndërsa barra ka rënë kryesisht në stafin korrektues dhe menaxhmentin e Qendrës Korrektuese për të Mitur që janë përgjegjës për sigurinë e tyre prandaj përballen me shumë probleme.

Trajtimi jo i duhur i të miturve të privuar nga liria e që janë përdorues të substancave narkotike ndikon në dështimin e zbatimit të programit të risocializimit.

Mungesa e një oferte konkrete nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për të miturit e dënuar dhe e Gjykatave për të miturit me masë edukative krijon ndjenjën e paperspektivës për të miturit e privuar nga liria duke ua marrë motivin për sjellje të mirë për faktin që shumë pak përfitojnë nga shkurtimet e dënimit apo falja, lirimi me kusht e kjo sidomos vlen për të miturit me gjendje ekonomike të rëndë dhe ata që nuk janë shtetas të Kosovës.

Të miturit me masë edukative apo të dënuar qëndrojnë në një hapësirë me të miturat me masë edukative dhe femrat e dënuara dhe kjo, nga aspekti i zbatimit të planit të risocializimit nuk ka kuptim dhe nuk prodhon rezultate të pritura.

Të miturit e dënuar apo ata me masë edukative duhet të gjithë të zhvendosen në Qendrën Korrektuese për të Mitur të tipit gjysmë të hapur që ishte përuruar vitin e kaluar dhe për çka kanë pasur premtim dhe nuk është vepruar kështu dhe ky diskriminim është dhe do të jetë burim i përhershëm i rebelimit të të miturve me masë edukative dhe atyre të dënuar për vepra penale.

Për këtë arsye, KMDLNj kërkon nga Shërbimi Korrektues i Kosovës që në bashkëpunim me Akademinë për Siguri në Vushtrri të pranojë një numër të oficerëve korrektues që do të shkolloheshin për punë vetëm me të mitur dhe femra dhe të cilët pastaj do ta kalonin një kohë në njërën nga Qendrat Korrektuese për të Mitur dhe Femra në shtetet evropiane apo SHBA ku do t'i përvetësonin shkathtësitë profesionale për të punuar me të mitur dhe femra.

Qendrës Korrektuese për të Mitur dhe Femra në Lipjan duhet t'i ndërrohet destinimi; ose të bëhet Qendër vetëm për femra dhe këtë propozim fuqishëm e përkrahë KMDLNj, ose do të bëhej qendër vetëm për të mitur të privuar nga liria e këtë fuqishëm e kundërshton KMDLNj-ja.

Në të kundërtën, gjithmonë do të përballemi vetëm me pasojat, pa pasur mundësi të ndërmarrjes së masave parandaluese.

# HOTI NË LUGINË TË PRESHEVËS PREZANTON PROGRAMIN NACIONAL PËR RININË

**Lugina e Preshevës, 25 shkurt (ER)** - Koordinatori Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rexhep Hoti, gjatë vizitës zyrtare në Luginë të Preshevës, ka takuar kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa. Hoti gjatë këtij takimi ishte i shoqëruar nga i ngarkuari me punë në Zyrën Ndërlidhëse të Kosovës në Serbi, Xhelal Shaqiri.

Në këtë takim u bisedua për Programin Nacional për Rininë dhe për gjendjen e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Koordinatori Hoti ka shpalosur Programin Nacional për Rininë, për të cilin ka theksuar se është program konkret që do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit. "Programi Nacional për Rininë është hartuar mbi dy parime themelore: gjithëpërfshirjen dhe vijueshmërinë. Ka fokusin në tri gara: kreativitet kulturor dhe mendim kritik, dituri dhe sport. Çdo vend i parë në çdo kategori do të shpërblehet. Garat do të organizohen në nivel shkolle, komune dhe republike. Përmes këtij programi u ofrohet nxënësve të Luginës që në nivel republike të garojnë me nxënësit e Republikës së Kosovës", ka thënë Hoti.

Ndërkaq kryetari Mustafa ka falënderuar koordinatorin Hoti që ka marrë hapa konkretë për bashkëpunimin e shqiptarëve edhe jashtë shtetit të Kosovës. "Ky program është i shkëlqyer. Me realizimin e tij nxënësit e Luginës do të ndihen si pjesë e Kosovës, rrjedhimisht unë e shoh këtë si pikënisje të bashkimit tonë me Kosovën. Ky program konkret do t'i integrojë të rinjtë shqiptarë në Kosovë", ka thënë Mustafa.

Programi Nacional për Rininë është hartuar për të gjithë nxënësit e të gjitha komuniteteve pa dallim. Ndërkaq Programi Ndërshtetëror për Rininë parasheh garat në nivel rajonal me shtetet e tjera të rajonit.

## Ngrihet aktakuzë për inkasantin që përvetësoi para në Pejë dhe Istog

**Pejë,25 shkurt (ER)** - Prokuroria Themelore e Pejës, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit A. B. për shkak të veprës penale "Përvetësimi në detyrë", nga neni 425, paragrafi 1 i KPRK-së dhe për veprën penale "Mashtrimi", nga neni 335, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas aktakuzës, i pandehuri A. B., nga data 19 dhjetor 2017 e deri më 2 mars të vitit 2018, në Komunë të Pejës dhe Istogut, në cilësinë e inkasantit të kompanisë KEDS, kishte përvetësuar shumën e parave prej 290 eurosh nga të dëmtuarit R. M., Q. K., E. G. dhe N. Z., në emër të inkasimit për energjinë elektrike të shpenzuar dhe për t'i

deponuar te zyrat e KEDS-it, mirëpo të njëjtat i kishte përvetësuar.

Të pandehurit, edhe pse iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës nga kompania KEDS më 4 maj 2018, i njëjti më 28 maj 2018, në fshatin Suhogerllë të Komunës së Istogut, përmes paraqitjes së fakteve të rreme, kishte veshur uniformën e punës dhe, duke u paraqitur si punëtor i KEDS-it, kishte përvetësuar shumën e të hollave prej 70 eurosh nga të dëmtuarit Sh. S. dhe I. V., kinse për pagesë të energjisë elektrike. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka përmbushur elementet e veprave penale të përshkruar si më lart. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit për veprat penale të cilat i vihen në barrë.

## Koreja e Jugut e njeh Guaidon si president të përkohshëm të Venezuelës

**SEUL, 25 SHKURT** - Ministria e Punëve të Jashtme e Koresë së Jugut njoftoi se e njeh Juan Guaidon president të përkohshëm të Venezuelës. Udhëheqësi i opozitës, Juan Guaido, e deklaroi veten president të përkohshëm të vendit në fund të janarit. Ai është njohur nga Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende perëndimore. Presidenti i kontestuar i Venezuelës, Nicolas Maduro, mbështetet nga Rusia, Kina, Meksika dhe një sërë vendesh të tjera.

Kriza në Venezuelë është thelluar ditët e fundit pasi presidenti i kontestuar, Nicolas Maduro, vendosi mbylljen e kufijve për të mos lejuar ndihmat e huaja të hyjnë në vend. Miliona banorë të Venezuelës janë duke u përballur me krizën e furnizimit me ushqim përderisa ekonomia e vendit është e shkatërruar nën udhëheqjen e Maduros.

# Trumpi, optimist për takimin me udhëheqësin e Koresë së Veriut

**Në takimin e tyre këtë javë në Vietnam, presidenti amerikan Donald Trump po parashikon marrëdhënie të mira me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un**

**UASHINGTON, 25** shkurt - Presidenti amerikan Donald Trump po parashikon marrëdhënie të mira me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, në takimin e tyre këtë javë në Vietnam, ndërsa Shtëpia e Bardhë shprehet se synimi kryesor i bisedimeve është çarmatimi bërthamor i Koresë së Veriut.

"Ne kemi pajtueshmëri, gjë që do ta shihni gjithnjë e më shumë gjatë ditëve në vijim", tha Trumpi. "Do të kemi një takim shumë interesant dyditor në Vietnam", u shpreh presidenti gjatë takimit me një grup guvernatorësh të shteteve amerikane në Shtëpinë e Bardhë. "Kemi një shans për çarmatim të plotë bërthamor të një pjese të botës që ishte shumë e rrezikshme", tha ai.

Dy udhëheqësit u takuan qershorin e kaluar, ku më pas Trumpi deklaroi se "nuk ka më një kërcënim bërthamor nga Koreja e Veriut". Por, ndërsa ai takohet të mërkurën dhe të enjten me udhëheqësin Kim në Hanoi, kryeqyteti i Vietnamit ka pak prova konkrete se është bërë përparim për kushtet specifike lidhur me çarmatimin e premtuar bërthamor të Koresë së Veriut. Kur u pyet se cili do të ishte përkufizimi i çarmatimit, një zyrtar i lartë i administratës së presidentit Trump nuk pranoi të diskutonte këto detaje duke theksuar bisedimet në vazhdim. "Jemi në mes të negociatave me Korenë e Veriut dhe nuk jam i gatshëm të flas për qëndrimin e tyre ndërsa jemi ende duke negociuar. Mjafton të them se ne po diskutojmë për këtë dhe për shumë çështje të tjera këtë javë", tha zyrtari i lartë.

Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, tha se "nuk ka ndryshime" në sanksionet ekonomike amerikane ndaj Koresë së Veriut derisa ky vend të pajtohet me "çarmatimin bërthamor plotësisht të verifikueshëm". Ai tha se ShBA-ja është e gatshme të ofrojë "garanci në fushën e sigurisë" që Koreja e Veriut të mbijetojë si një shtet i pavarur, që "Koreja e Veriut të bëhet si Koreja e Jugut", një fuqi ekonomike. Ai tha se ShBA-ja po i ofron Koresë së Veriut një alternativë, që ky vend të mos kthehet "në një shtet të izoluar në arenën ndërkombëtare".

Por kryediplomati amerikan e pranoi se duhet shumë punë për arritjen e një marrëveshje, se si dhe kur Pheniani do ta shkatërrojë arsenalin e tij bërthamor. "Një hap i verifikueshëm drejt çarmatosjes është gjëja kryesore ku është përqendruar presidenti Trump", tha Pompeo. Ai shtoi se zyrtarët amerikanë janë të vetëdijshëm për historinë e Koresë së Veriut, që gjatë dekadave ka bërë premtime për çarmatosjen dhe pastaj nuk i ka respektuar marrëveshjet.

Presidenti Trump është nisur të hënën për në Hanoi, ndërsa udhëheqësi Kim ka udhëtuar tashmë me një tren të blinduar drejt Vietnamit. Media shtetërore e Koresë së Veriut fotografoi udhëheqësin Kim duke hipur në tren, duke njoftuar se ai po shkonte drejt Vietnamit për takimin me presidentin amerikan për herë të dytë. Kjo është hera e parë që media shtetërore koreano-veriore njofton për takimin.

### Fuqia ekonomike

Në muajt e hershëm të presidencës së tij, Trumpi tha se do t'u përgjigjej me "zjarr dhe forcë të paparë ndonjëherë në botë" kërcënimeve të Koresë së Veriut kundër ShBA-së dhe aleatëve të tyre. Por të dielën, Trumpi përmes një postimi në "Twitter" u shpreh për "Marrëdhënie të mira me kryetarin Kim!"

Udhëheqësi amerikan tha se kryetari Kim e kupton, ndoshta më mirë se askush tjetër, se pa armë bërthamore vendi i tij mund të bëhet shpejt një nga fuqitë më të mëdha ekonomike në botë. Për shkak të vendndodhjes, njerëzve dhe vetë atij, ky vend ka më shumë mundësi për rritje të shpejtë sesa asnjë shtet tjetër.

Presidenti Trump tha se presidenti kinez Xi Jinping "ka qenë shumë i dobishëm duke mbështetur takimin e tim me Kim Jong Unin. Gjëja e fundit që Kina do të dëshironte, do të ishte një vend fqinj me armë të shumta bërthamore. Sanksionet e vëna nga Kina dhe Rusia kanë qenë shumë të dobishme".

Zyrtarët amerikanë të zbulimit dyshojnë se Koreja e Veriut synon t'i mbajë premtimet e bëra në Singapor nga kryetari Kim për çarmatimin bërthamor.

Drejtori i Zbulimit Kombëtar, Dan Coats, i tha një komisioni të Kongresit Amerikan muajin e kaluar, se Koreja e Veriut "ka ndërprerë qëndrimet provokuese" duke mos zhvilluar prova me raketa dhe bërthamore prej më shumë se një viti. "Po ashtu, Kim Jong Un vazhdon të demonstrojë se është i hapur ndaj çarmatimit të Gadishullit Korean", tha Coats.

Por, pavarësisht prej ndërprerjes së provave, tha Coasts, "aktualisht vlerësimi ynë është se Koreja e Veriut do të kërkojë t'i ruajë aftësitë e saj me armë të shkatërrimit në masë dhe se nuk ka gjasa të heqë dorë plotësisht nga armët bërthamore dhe aftësia për t'i prodhuar ato". "Vlerësimi ynë përforcohet nga vëzhgimet për disa aktivitete që bien ndesh me çarmatimin bërthamor", shtoi ai. Coats tha se udhëheqësi i Koresë së Veriut dhe pjesa tjetër sunduese e vendit i konsiderojnë armët bërthamore si kritike për mbijetesën e regjimit.

## BE-ja i propozon Britanisë ta shtyjë daljen nga blloku

**BRUKSEL, 25 SHKURT** - Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, ka rritur presionin ndaj kryeministres britanike Theresa May për ta shtyrë daljen e Britanisë nga Bashkimi Evropian. Tusk ka thënë se kjo do të ishte një "zgjidhje e arsyeshme" dhe se 27 anëtarët e bllokut do të tregojnë mirëkuptim dhe vullnet të mirë për ta bërë të mundur këtë shtyrje.

Deklaratat e zyrtarit të lartë evropian u bënë pasi bisedimet dyditëshe ndërmjet kryeministres May dhe udhëheqësve evropianë nuk arritën ndonjë rezultat.

Kryeministrja May po përpiqet t'i bindë vendet evropiane për disa ndryshime të marrëveshjes së Brexitit që kanë të bëjnë me kufirin irlandez. Kjo po kundërshtohet nga BE-ja përderisa pa një ndryshim të tillë marrëveshja nuk mund të kalojë në parlamentin britanik.

Parlamenti britanik e ka hedhur poshtë njëherë marrëveshjen duke e bërë të paqartë mënyrën e daljes së Britanisë nga Bashkimi Evropian. Ekspertët vlerësojnë se një dalje e çrregullt e Britanisë nga BE-ja do të mund të shkaktonte krizë në tregjet financiare.

# *BeyAb* for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

E rrallë

# Kaloi 39 vjet në burg për një krim që nuk e kishte kryer

Craig Coley kurrë nuk duhet t'i kishte kaluar 39 vjet në burg. Ai u dënua për një krim që nuk e kishte bërë. 71-vjeçari u akuzua për vrasjen e Rhonda Wicht dhe djalit të saj katërvjeçar, Donald, në vitin 1978. Por, 39 vjet më pas, Coley është shpallur i pafajshëm dhe do marrë një shpërblim prej 21 milionë dollarësh. Çështja u rihap pas kaq shumë vitesh dhe nga provat e AND-së, rezultoi se Colei nuk ishte vrasësi.

## FOTO E DITES

Një grup nget biçikletat në rrugën al-Jabal gjatë fazës së tretë të turneut të Omanit, në Qurayyat. /AFP/

E jashtëzakonshme

# Ushtritë e karkalecave po përhapen me shpejtësi në disa shtete

Një shpërthim karkalecash në Sudan dhe Eritrea po përhapet me shpejtësi përgjatë dy anëve të Detit të Kuq, për në Egjipt dhe Arabinë Saudite, ka njoftuar Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara. Periudhat e shiut përgjatë bregdetit të Detit të Kuq në Eritre dhe Sudan kanë lejuar dy gjenerata mbarështimi që nga muaji tetor, duke çuar në një rritje të konsiderueshme të karkalecave dhe formimin e ushtrive prej miliona anëtarësh që konsumojnë gjithçka që gjejnë përpara.

## BARSOLETA E DITËS

**- Me çfarë veprimi mund ta zhbllokojë polici kaosin në udhëkryq?**

**- Vetëm nëse merr pauzë.**

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Në ora 16:00**

### "THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

**Në ora 17:30**

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

**Në ora 19:30**

### "MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

**Në ora 22:00**

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Personat pranë jush janë disi të bezdisur nga sjellja juaj kohët e fundit. Do të preferonin t'ju shihnin siç keni qenë gjithmonë.

**DEMI**
Në të ardhmen nuk keni pse fshiheni pas premtimeve boshe që ju kanë bërë. Është mirë të filloni ta krijoni pavarësinë tuaj.

**BINJAKËT**
Megjithëse jeni përpjekur me mish e me shpirt të përfundoni një projekt të caktuar, kushtet dhe rrethanat nuk jua kanë lejuar këtë gjë.

**GAFORRJA**
Lejojini një personi t'ju japë zgjidhjet e veta sot. Me pak mbështetje mund të bëhet aleati më i mirë i juaji në të ardhmen.

**LUANI**
Aktivitetet që keni për sot mos i shtyni për një afat të pacaktuar. Shumë gjëra do të jenë në varësi të situatave të krijuara ditën e sotme.

**VIRGJËRESHA**
Nuk keni një gjykim të drejtë mbi situata dhe persona të caktuar. Prisni të jeni të sigurt përpara se ta shprehni opinionin tuaj.

**PESHORJA**
Do të ndikoheni nga persona që do t'jua ndryshojnë totalisht këndvështrimin e gjërave. Jeni bërë fleksibël kohët e fundit.



**AKREPI**
Sot duhet të lini mënjanë krenarinë tuaj dhe të bëni ç'është e mundur për të finalizuar një projekt të përbashkët. Do të shpërbleheni për mundin.



**SHIGJETARI**
Çdo gjë që keni zgjedhur të bëni sot do të përkojë me planet tuaja për ditën. Jeni më të qetë kur bëni një planifikim paraprak.



**BRICJAPI**
Shumë njerëz mësojnë nga gabimet e tyre dhe e njëjta gjë do t'ju ndodhë edhe ju. Përvoja ju ka bërë më të ftohtë në marrëdhënie.



**UJORI**
Keni bërë zgjedhje të rëndësishme dhe sot nuk mund të ktheheni pas edhe nëse do të dëshironit. Pak më fleksibël në raport me partnerin sot.



**PESHQIT**
Po vini në pikëpyetje të gjithë gjërat që një person i afërt ka bërë për ju. Shumë shpejt do ta kuptoni që keni gabuar në disa raste.

# Kylie Jenner shkëput të gjitha marrëdhëniet me Tristan Thompsonin

Biznesmenja Kylie Jenner ka larguar nga miqësia, në llogarinë e vet në "Instagram", Tristan Thompson, i cili ishte i dashuri i motrës së saj, Khloe Kardashian. Tristan Thomspn ka tradhtuar motrën e Kyliet me shoqen e saj më të mirë. Kështu, sipas "Daily Mail"-it, tek pas gjashtë dite të këtij skandali, Jenneri ka larguar nga shoqëria në "Instagram" Tristanin.

# Bella Hadidi shkëlqen në të bardhë

Modeluesja e "Victoria Secret", Bella Hadid, është fotografuar nga paparacët të dielën në aeroportin e Milanos. Hadid pati të veshur pantallona dhe bluzë ngjyrë të bardhë.

# Lady Gaga fiton Oscarin e parë

Lady Gaga ka fituar çmimin e parë të Oscarit për "Këngën më të mirë origjinale". Ky çmim i është ndarë së bashku me tekstshkruesit e "Shallow", Mark Ronson, Anthony Rossomando dhe Andrew Wyatt. Gaga e emocionuar ka falënderuar kolegun e saj Bradley Cooper. "Nuk ka asnjë njeri në këtë planet që mund ta këndonte këtë këngë me mua, pos teje", ka thënë ajo në fjalimin e saj.

# R Kelly mund t'i shpëtojë burgimit

Reperi i njohur R Kelly po përballet me dhjetëra akuza për abuzime seksuale, që mendohet se kanë ndodhur përgjatë disa vjetëve. Para dy ditësh u lëshua një urdhërarrest ndaj tij dhe këngëtari u arrestua në Chicago pasi akuzohet për abuzimin seksual të katër femrave, përfshirë tri ferma të mitura. Megjithatë, reperi i njohur mund të lirohet me kusht nëse paguan një milion dollarë. Reperi është urdhëruar gjithashtu ta dorëzojë pasaportën e tij dhe të mos ketë kontakte me asnjë të mitur nën moshën 18-vjeçare.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | LEICESTER CITY - BRIGHTON | 1 | BENEVENTO - PESCARA | 1 | LAZIO - MILAN | GG |
|---|---|---|---|---|---|---|

# Hajrizi: Asgjë nuk është e paarritshme

Drilon Hajrizi është shumë optimist se Kosova ka ende shanse për të siguruar një vend në "Eurobasket 2021". "Kundërshtarët janë shumë kualitativë, sidomos Britania e Madhe, por shpresoj se ekipi do të përgatitet maksimalisht. Asgjë nuk është e paarritshme", ka thënë Drilon Hajrizi për "Epokën e re"

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 25 SHKURT - Basketbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në Basketboll, Drilon Hajrizi, ka thënë se humbja nga Rumania erdhi për shkak të shumë faktorëve. Sipas tij, rumunët zhvilluan një lojë të mençur e cila ia solli fitoren të dielën në Prishtinë. "Mendoj se loja ka pasur periudha të mira për t'u dëshiruar, por kishte edhe periudha shumë të këqija. Ne kemi shumë talente në ekip ashtu sikurse edhe ekipi kundërshtar, Rumania, por ne nuk i shfrytëzuam përparësitë dhe kapacitetet që kishim. Nuk kishim përqendrimin e duhur në fund të ndeshjes, por edhe mungesa e përvojës ka ndikuar që të humbim këtë ndeshje. Kundërshtari luajti me shumë pjekuri dhe me një lojë shumë kolektive duke i ndihmuar njëri-tjetrit si në sulm, po ashtu edhe në mbrojtje, prandaj në fund edhe doli fitimtar", ka deklaruar Hajrizi.

Pavarësisht prej humbjes nga Rumania, gjasat e Kosovës ende nuk janë shuar që Kosova të jetë pjesë e "Eurobasket 2021". "Dardanët" janë sistemuar në Grupin B së bashku me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe. Lidhur me këta dy kundërshtarë, Hajrizi ka deklaruar se asgjë nuk është e pamundur. "Kundërshtarët janë shumë kualitativë, sidomos Britania e Madhe, por shpresoj se ekipi do të përgatitet maksimalisht dhe asgjë nuk është e paarritshme", ka thënë Hajrizi për "Epokën e re". Basketbollisti nga Mitrovica rikthehet në Përfaqësuesen e Kosovës në basketboll pas një kohe të gjatë. Lidhur me këtë rikthim, Hajrizi ka treguar se po ndihet mirë, por ajo që e pikëllon njërin nga basketbollistët më të mirë në vend është humbja e pësuar. "Për një lojtar reprezentacioni është e arritura më e madhe të cilën e përjeton. Sinqerisht jam ndier shumë mirë për rikthim, por po ndihem keq që nuk mund ta ndihmoj Kosovën për të shënuar fitore", ka shtuar Hajrizi.

**GRUPI G**

**3 gusht 2019 Luksemburgu - Kosova**
**7 gusht 2019 Kosova - Britania e Madhe**
**14 gusht 2019 Kosova - Luksemburgu**
**17 gusht 2019 Britania e Madhe - Kosova**

### Kosova, në grup me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe

Pas përfundimit të raundit të dytë të fazës parakualifikuese për "Eurobasket 2021", skuadrat lidere të secilit grup kanë vazhduar tutje, pra e kanë siguruar vendin në kualifikime, kurse dy ekipet e fundit të grupeve tani janë sistemuar në grupe të tjera dhe kështu e kanë fituar edhe një shans për të siguruar një vend në kualifikimet për Eurobasketin që do të mbahet pas dy vjetëve. Kosova si e treta në Grupin B tashmë është sistemuar në Grupin G së bashku me Luksemburgun dhe Britaninë e Madhe. Raundi i tretë i parakualifikimeve për "Eurobasket 2021" do të zhvillohet prej 3 deri më 21 gusht. Fituesi i grupit do ta sigurojë një vend për në kualifikime për "Eurobasket 2021".

SHKURT

## Zeneli: Golin ia dedikova dikujt special. E di ajo

Ylli i Kosovës, Arbër Zeneli, ia ka dedikuar golin e parë me Stade de Reims, një personi të veçantë, për të cilën thotë se e di vetë ajo. Zeneli shënoi të dielën golin e parë me fanellën e Reimsit në fitoren 2 me 4 ndaj Montpellierit. Ai, po ashtu, asistoi në këtë fitore. "Shpirt fantastik i ekipit. I lumtur që shënova golin e parë për klubin. Golin ia dedikova dikujt special. E di ajo", ka shkruar ai duke shtuar edhe një simbol të zemrës në postimin në "Instagram".

## Ballacku: Hazardi qëndron nëse Chelsea lufton për trofe

Legjenda e Chelseat, Michael Ballack, i ka dhënë një ide ish-klubit të tij se si duhet të veprojë me lojtarët më të mirë të skuadrës. "Ndër këto pak vite, Chelsea ka humbur qëllimin e tyre, duke harruar ndjenjën se si është të luftosh për trofe. Në momentin që Hazardi mendon se klubi më nuk mund të fitojë trofe, atëherë ai do të mendojë ndryshe. Chelsea duhet t'i ofrojë kushte atij që të mund ta rikthejë besimin në skuadër dhe të mendojë për trofe të mëdhenj", ka thënë Ballacku.

## Zbulohen faktet e reja për vdekjen tragjike të Emiliano Salas

Janë zbuluar këto ditë disa fakte të reja që kanë qartësuar disi më shumë rrethanat e aksidentit fatal që i mori jetën Emiliano Salas, trupi i të cilit u gjend para pak javësh në fundin e kanalit të La Manshit. Dega e hetimeve të aksidenteve ajrore ka publikuar një raport mbi këtë aksident. Në këtë raport thuhet se avioni humbi kontrollin dhe ra në det, i ndarë në tre pjesë. Kjo gjë tregon se piloti është munduar të reagojë, por pa mundur ta evitojë rënien fatale. Gjithashtu, në këtë raport thuhet se piloti nuk kishte kualifikimin e duhur dhe nuk kishte udhëtuar në kushte të vështira, gjatë natës. Piloti Ibotson kishte një licencë private dhe jo atë komerciale që nevojitet. Në ditët në vijim do të publikohet shkaku kryesor i rënies së avionit të Salas. Për t'u përmendur është fakti se deri tash nuk është gjetur ende trupi i pilotit. Kërkimet po vazhdojnë, por pa rezultat.

## Gjilani mohon emërimin e Sherifit në postin e trajnerit

GJILAN, 25 SHKURT - Sallah Sherifi nuk do të jetë trajner i ri i skuadrës së Gjilanit, por do të vazhdojë të jetë drejtor sportiv. Skuadra nga Anamorava në një njoftim në faqen zyrtare në "Facebook" ka bërë me dije se Sherifi do të mbetet në pozitën aktuale, kurse skuadrës do t'i prijë Alban Hyseni deri në gjetjen e një trajneri të ri. "Me anë të kësaj komunikate duam ta informojmë opinionin publik që, pas lajmeve të fundit, se drejtori sportiv, Sallah Sherifi, ka marrë drejtimin e skuadrës, nuk qëndrojnë dhe janë të pavërteta. Klubi i Futbollit SC Gjilani njofton se skuadra është në bisedime me disa trajnerë dhe se ende nuk kanë marrë ndonjë vendim përfundimtar se kush do ta udhëheqë ekipin në pjesën e mbetur kampionale. Në krye të shtabit teknik të skuadrës mbetet Alban Hyseni deri në vendimin final të kryesisë së Klubit të Gjilanit", thuhet në njoftimin e Gjilanit.

## Vjen humbja e dytë radhazi për San Antonion

**Nju Jork, 25 shkurt** - Është luajtur vetëm një ndeshje në kampionatin më të fortë të botës në basketboll. San Antonio Spurs është mundur për herë të dytë radhazi në NBA në ditët e fundit. Ka qenë New York Knicks, skuadra që ka triumfuar në shtëpi, në "Madison Square Garden", me rezultatin 130-118. Vendësit nuk e kanë diskutuar për asnjë moment fitoren, teksa ka spikatur Damyean Dotson. Ky i fundit shënoi 27 pikë. Pas tij vijnë Kevin Knox me 19 pikë dhe 10 kërcime, si dhe Dennis Smith Jr. me 19 pikë dhe 13 asistime. Te bardhezinjtë, DeMar DeRozan ishte më i miri, me 32 pikë. Pas kësaj humbjeje, San Antonio pozicionohet e shtata në klasifikimin e Konferencës Perëndimore, ndërsa New York Knicku i 15-ti në Konferencën Lindore.

# Gashi: Palestra që zgjati 13 vjet për t'u ndërtuar, përfundon në qershor

**Istog, 25 shkurt** - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka vizituar Palestrën Sportive në Istog, ku ka takuar hendbollistet e Istogut. Ai gjatë kësaj vizite është zotuar se kjo palestër sportive do të përfundojë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, i cili ka qenë projekt i stërzgjatur. "Janë këto projekte që nuk janë përfunduar dhe janë stërzgjatur shumë. Ka 13 vjet që ka filluar një dramë e paarsyeshme që ky projekt nuk ka përfunduar për sportistët e sportdashësit dhe hendbollistet e Istogut që kanë treguar sukses të mirë dhe zotohem se ky projekt do përfundojë në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019. Mjetet financiare janë të siguruara. Kërkova nga kompania që në qershor ta dorëzojë palestrën dhe ne t'ia dorëzojmë komunës dhe sportdashësve", ka thënë Gashi. "Është investim kryekëput i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe besoj se do jemi të vendosur që për këta pesë muaj që kanë mbetur këtë palestër t'ia dorëzojmë Komunës së Istogut. Ne gjatë këtij viti të gjitha palestrat që

kanë filluar vite më parë janë duke përfunduar si në Shtime dhe Rahovec që i kemi dorëzuar dhe kjo do të jetë palestra e radhës që t'ua dorëzojmë autoriteteve komunale", ka shtuar ministri Gashi. Numri një i MKRS-së ka bërë me dije se institucioni që ai e drejton po i ndihmon të gjitha klubet që po tregojnë sukses dhe rezultate. "Kur klubi hendbollistik i vajzave hyri në 16-shen më të mirën në Evropë e kemi takuar dhe e kemi mbështetur për nevojat që ka. Edhe klubet që kanë suksese dhe rezultate jemi duke i mbështetur drejtpërdrejt", ka përfunduar Gashi.

# Neymari: Messi është më i miri në botë

**Barcelonë, 25 shkurt** - Neymar Jr, i cili po riaftësohet nga dëmtimi në shputën e këmbës (këto ditë ndodhet në Brazil), dha një intervistë për "Esporte Spectacular", që ka publikuar një pjesë paraprake të asaj që ka thënë ylli i PSG-së. Kur ishte duke folur për ish-bashkëlojtarin e tij te Barcelona, Lionel Messi, intervista u bë më emocionale për Neymarin. Argjentinasi dhe braziliani ndanë një dhomë zhveshjeje për katër sezone, gjatë kohës së tij në "Camp Nou", përpara se të transferohej te PSG-ja për një rekord botëror prej 222 milionë eurosh. Neymari arriti te Barcelona 21 vjeç nga Santosi, në vitin 2013, dhe u mor shpejt nën mbrojtje nga Messi. Edhe në intervistën me "Esporte Espetacular" në "GloboTV" të Brazilit, sulmuesi i PSG-së nuk i mbajti lotët, kur kujtoi kohën e kaluar me superstarin argjentinas. Për këtë të fundit thotë se e ndihmoi në një moment, kur kishte nevojë më shumë për këtë. "Sinqerisht, është e vështirë, shumë e vështirë për mua që të flas për Messin. Ai ishte shumë i veçantë

për mua në Barcelonë, e them këtë për të gjithë. Në momentin kur më duhej mbështetja më e madhe, lojtari më i mirë në botë mbërriti dhe më dha një dorë. Ai më tha: Eja, unë jam këtu për t'ju ndihmuar!" Neymari vazhdoi të shpjegojë se me mbërritjen e tij në Barcelonë, teksa Messi e këshilloi të mos ishte i turpshëm dhe të mos kishte frikë prej atij dhe askujt në klub. Gjatë kohës së tij në "Camp Nou" braziliani shënoi 105 gola në 186 ndeshje. Po ashtu, u vlerësua si lojtari i tretë më i madh në botë, pas Messit dhe Cristiano Ronaldos. Intervista e plotë e tij do të transmetohet në "GloboTV" më 3 mars.

## SHKURT

### Bardhi kritikon lojtarët e Realit

Enis Bardhi e ka komentuar ndeshjen në mes të Levantes dhe Real Madridit (1-2). Sulmuesi shqiptar ka thënë se Levante e ka merituar së paku një pikë nga kjo ndeshje. "Ne luajtëm një ndeshje të mirë dhe merituam më shumë, mirëpo ishte shumë e vështirë pasi lojtarët e Realit binin në tokë çdo dy minuta. Tanimë dëshirojmë të jemi të përgatitur mirë dhe t'u kthehemi fitoreve", ka thënë Bardhi.

### Mourinho: Hazardi, ideal për Realin

Ish-trajneri i Chelseat, Jose Mourinho, beson se Eden Hazardi do të përshtatej shumë mirë në Real Madrid. Ylli belg ka kontratë me Chelsean deri në vitin 2020, kurse ka luajtur nën urdhrat e Mourinhos gjatë periudhës së dytë të portugezit si trajner i të kaltërve. "A ka talent ai për të luajtur për Real Madridin? Po, ka", ka thënë Mourinho. "A e ka personalitetin për ta veshur një fanellë me ndikim të madh dhe për të luajtur para tifozëve në 'Bernabeu'? Po, ai e ka këtë personalitet", ka shtuar Mourinho.

### Allegri: Përballja me Napolin, e rëndësishme para Atleticos

Trajneri i Juventusit, Masimiliano Allegri, ka vlerësuar se përballja me Napolin është shumë e duhur për "Zonjën e Vjetër" para ndeshjes së kthimit ndaj Atletico Madridit. "Sfida kundër Napolit? Për mua është e duhura. Do të jetë një test shumë i rëndësishëm për ne para sfidës së kthimit kundër Atleticos", ka thënë Allegri.

### Milani dhe Valencia e kërkojnë Falcaon

Sulmuesi Radamel Falcao ka kontratë me Monacon deri në vitin 2020, por në afatin kalimtar të verës pritet të largohet nga kjo skuadër. Interesim për shërbimet e tij kanë shfaqur Milani dhe Valencia por, sipas raportimit të medieve në Francë, sulmuesi preferon me shumë kalimin në La Liga. Sulmuesi kolumbian që nuk po tregon formë të mirë si pasojë e lëndimeve të shpeshta, ka luajtur në të kaluarën për Chelsean, Manchester Unitedin, Atletico Madridin, Porton, River Platen dhe Lanceros Boyaca.

### City 'blindon' Laporten

Manchester City 'blindon' Aymeric Laporten, duke i rinovuar kontratën deri në vitin 2025. Mbrojtësi francez brenda pak muajsh është shndërruar në shtyllë të mbrojtjes së Pep Guardiolës, duke qenë një titulluar i padiskutueshëm. 24-vjeçari u transferua në Angli verën e vitit 2018 nga spanjollët e Athletic Bilbaos. Për shërbimet e tij, Manchester City i pagoi klubit bask klauzolën e lirimit nga kontrata, në shumën 65 milionë euro. Në këtë sezon Laporte ka luajtur në 37 takime në të gjitha kompeticionet, duke arritur të shënojë 4 gola, ndërsa ka dhënë edhe një asistim.

### Bayerni, 120 milionë euro për Asension

Bayern Munchen është i gatshëm të ofrojë 120 milionë euro për anësorin e Real Madridit, Marco Asension, sipas "Don Balon". Spanjolli Asensio nuk ka gjetur shumë hapësirë në formacionin startues të Santiago Solarit deri tani këtë sezon dhe mund të largohet në verë, sipas mediumit spanjoll. Bayern duket se është i gatshëm të bëjë ofertë marramendëse prej 120 milionë eurosh për shërbimet e tij. Raportohet se kampioni gjerman tashmë e ka kontaktuar futbollistin dhe i ka ofruar atij kontratë joshëse në përpjekje për ta bindur të kalojë në Bundesligë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria –Vlada-Government
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
Univerziteska Bolnička i Klinička Služba Kosova- Hospital and Univesity Clinical Service of Kosovo
Spitali i Përgjithshëm –Opsta Bolnica –Genel Hastane "Prim.Dr.Daut Mustafa" Prizren

Nr./br./nr. 8/5
Më/dana/tarih: 25.02.2019
P r i z r e n

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, nenit 6, pika 5.1 të Udhëzimin Administrativ (MPMS)Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, kërkesës nga drejtori i përgjithshëm i SHSKUK-së më datën 06.02.2019, si dhe nenit 13, pika 1.1 të Statutit të Spitalit, Këshilli Drejtues i Spitalit të Përgjithshëm shpall/ Na osnovu člana 8 Zakona br. 03 / L-212 o radu, član 6, član 5.1 Administrativnog uputstva (MRSZ) 07/2017, zahtjev generalnog direktora SHSKUK-a od 06.02.2019 i člana 13, tačka 1.1 Statuta bolnice, Upravni odbor Opšte bolnice objavljuje/ Sayılı Kanunun 8 inci maddesine dayanarak. 03 / L-212 Çalışmanın, Madde 6, İdari Talimatın 5.1. Maddesi (MLSW) 07/2017 SHSKUK Genel Müdürü'nün 06.02.2019 tarihli ve 13 üncü Maddesi'nin talebi üzerine Hastane Statüsü'nün 1.1:

**Përsëritje të pjesërishme të konkursit publik, nr. 8/4**
**Ponavlanje jednog dela konkursa, br. 8/4**
**8/4 no'lu iş ilaninin kismi tekrari**

Dëshiron të pranojë në punë në kohë të pacaktuar / želi da primi na posao na neodredjeno vreme / Süresiz çalışan aranıyor
Titulli i pozitës / Naziv polozaja / Pozisyonun başlığı:
Mjekë specialistë-/Lekara specialista/ Doktorlar uzmanları:

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Mjekë Specialistë | Kërkuar |
| 2. | Mjekë Specialist i biokimisë | 1 |
| 3. | Mjekë Specialist dermatolog | 2 |
| 4. | Mjekë Specialist kirurg maksillofacial | 3 |
| 5. | Mjekë Specialist kirurg vaskular | 1 |
| 6. | Mjekë Specialist ortoped | 1 |
| 7. | Mjekë Specialist psikiatër i fëmijëve | 1 |
| 8. | Mjekë Specialist radiolog | 1 |

- Koeficienti i pagës: (8.4)
- Norma e punës: Orar i plotë (40 orë në javë)
- Kontrata: Sipas legjislacionit në fuqi
- Kualifikimi i kërkuar për mjekë specialistë / Kvalifikacija koja se zahteva za spec.lekara / Doktorlar uzmanları için gerekli yeterlilik: Fakulteti i Mjekësisë, specializimi në fushën përkatëse/ Medicinski Fakultet, Specializacija na relavantan oblast/ Tıp Fakültesi, ilgili alanda uzmanlık.
- Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen / Veštine, iskustvo i druge osobine koje se zahtevaju. / Beceriler, deneyim ve gerekli diğer özellikler. Të ketë aftësi organizative në profesion/Da ima sposbnost organizacije na radu / Mesleğinde örgütsel becerilere sahip olmak. Të njohë së paku një gjuhë vendore dhe është e dëshirueshme njohja e gjuhës angleze dhe puna me kompjuter/Znati najmanje jedan lokalni jezik i poželjno je znanje engleskog jezika i rad na kompijuteru / En az bir yerel dili tanımak ve İngilizce bilmek ve bilgisayarlarla çalışmak arzu edilir.
- **Dokumentat e kërkuara / Trazena dokumentacija / Gerekli belgeler:**

1. Diploma e Fakultetit të Mjekësisë / Diploma medicinskog fakulteta/ Tıp Fakültesi Diploması
2. Licenca e punës nga Ministria e Shëndetësisë nga lëmia përkatëse / Licenca rada od Ministrarstvo Zdravja relavantan oblast / Çalışma Ruhsatı İlgili alanda Sağlık Bakanlığı tarafından
3. Certifikatën e lindjes / izvod rodjenih / Doğum belgesi;
4. Certifikatën që nuk jeni i dënuar dhe nën hetime / Izvod da niste osudjeni ili pod istragom / Hükümlü ve soruşturma altında olmadığınızı gösteren belge;

**Procedurat e konkurrimit/Procedure konkurisanja/Rekabet Prosedürleri:** Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar/Konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate/Yarışma ilgilenen tüm adaylara açıktır
Konkursi është i shpallur 15 ditë / Konkurs je otvaran 15 dana/ Konkurun açılış ve kapanış tarihi: prej/od 25.02. 2019 deri/do 11.03.2019.
Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriterët e konkursit do t'i nënshtrohen testit me shkrim. Të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa, të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtruar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit intervistues. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitojë çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).
Samo kandidati koji su ispunili kriterijume konkursa će biti pozvani na test. Kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkurisanja biće pozvani na pismeni test. Svi kandidati koji ne polože pismeni test preko 50% biće automatski diskvalifikovani. Dok će svi kandidati koji su podnijeli pismeni test i uspjeli da ga polože 50% i više bodova, biti će pozvani na razgovor sa komisijom za intervjue. Rangiranje kandidata će se zasnivati na ukupnom broju bodova koji će se osvojiti svaki kandidat iz dva gore navedena procesa (pismeno testiranje i usmeni intervju).
Teste yalnızca rekabet kriterlerini karşılayan adaylar davet edilecektir. Yarışma kriterlerini karşılayan adaylar yazılı bir sınava tabi tutulur. Yazılı sınavı geçemeyen bütün adaylar% 50'yi geçemezse otomatik olarak diskalifiye edilirler. Yazılı bir sınavda bulunan ve puanlarının% 50'sini ve daha fazlasını geçmeyi başaran tüm adaylar görüşme komitesi ile görüşmeye davet edilecektir. Adayların sıralaması kazanılacak toplam puanlara göre belirlenir.Yukarıdaki iki süreçten her aday (yazılı sınav ve sözlü mülakatlar).

**Paraqitja e kërkesave/ Podnošenje prijave/ Uygulamaları gönderme:** Aplikacionet merren dhe dorëzohen në administratë. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës/ Aplikacije se primaju i podnose u upravi. U prijavi treba jasno navesti naziv posla i referentni broj/. Başvuru, iş unvanını ve referans numarasını açıkça belirtmelidir.
- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen / Aplikacije primljene nakon zatvaranja konkursa nece biti prihvacene. Nekompletirane aplikacije mogu biti odbijene. / Son tarihten sonra gönderilen talepler kabul edilmeyecektir. Eksik başvurular reddedilebilir.
- Emri, mbiemri dhe numri i telefonit të personit i cili mund të kontaktohet në rast të ndonjë pyetjeje/Ime, prezime i broj telefona osobe koju treba kontaktirati u slucaju bilo kakvih pitanja/Herhangi bir sorunuz olursa, irtibat kurulabilecek kişinin adı, soyadı ve telefon numarası

Drejtor i Administratës
Msc. Juridkut, Melinda Çollaku

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
*QEVERIA –VLADA-GOVERNMENT*

*MINISTRIA BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL*
*MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, SUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA*
*MINISTRY OF* AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT

**Agjencia Pyjore e Kosovës**
**Agencija za Šume Kosova**
**Kosovo Forest Agency**

Sektori i Burimeve Njerëzore
Kancelarija osoblja i razvoja ljudskih resursa
Office of Personnel and Human Resources Development

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës NR.03/L-149, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dhe Aprovimit paraprak në SIMBNJ nga DASHC/MAP me datën 25.02.2019, bënë:

SHPALLJEN E KONKURSIT TË JASHTËM NË AGJENCINË PYJORE TË KOSOVËS PËR KËTË VEND PUNE

